

## **Përmbledhje e takimit Informues mbi projektin SINCERE organizuar me stafin akademik dhe administrative në UGJ**

Në kuadrin e disseminimit të projektit SINCERE u organizua takimi informues me stafin akademik dhe administrative të UGJ-së. Projekti koordinohet nga **UNKO** (Universiteti Fan Noli Korçë) dhe është duke përmblyllur vitin e parë të jetës së tij (2025-2028). Prezantimi i projektit u fokusua në rëndësinë e tij për Arsimin e Lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor në vështrimin që:

- Projekti sjell politika dhe mekanizma konkrete, duke synuar në :
  - hartimin e politikave institucionale,
  - krijimin e mekanizmave monitorues,
  - përdorimin e software-ve anti-plagjiaturë,
  - dhe ngritjen e Task Forcës për Integritetin Akademik.

- Forcon kulturën institucionale të etikës dhe përgjegjësisë

Projekti kontribuon në:

- ndërtimin e një kulture akademike të ndershme,
- rritjen e përgjegjësisë profesionale

- Krijon mundësi për zhvillim profesional

Përmes projektit stafi do të përfitojë: njohuri mbi praktikat europiane; trajnime; bashkëpunim ndërkombëtar

- Rrit dukshmërinë dhe ndërkombëtarizimin e universitetit

Pjesëmarrja në një projekt Erasmus+:

- forcon profilin ndërkombëtar të universitetit,
- rrit bashkëpunimin rajonal dhe europian,
- 

Në vijim u evidentuan qëllimet dhe objektivat e projektit, paketat e punës si dhe kontributi i UGJ-së si bashkëudhëheqës i paketës 2 të punës (WP2), në krijimin dhe formalizimin e strukturave të Integritetit Akademik në institucionet partnere të konsorciumit në Kosovë dhe Shqipëri me qëllim forcimin e qeverisjes etike dhe standartizimin e mekanizmave institucionalë Integritetit Akademik. Për UGJ-në, pjesëmarrja në këtë projekt përfaqëson një mundësi të rëndësishme për zhvillim institucional, bashkëpunim ndërkombëtar dhe harmonizim me standardet europiane të arsimit të lartë.







